



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 25-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 29. 01. 2016 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Agron Hajdini, anëtar
5. Arton Retkoceri, anëtar
6. Naim Jahiri, anëtar
7. Burbuqe Fazliu, anëtar
8. Linda Shahini, anëtar
9. Xhevat Olluri, anëtar
10. Rizah Bajraktari, anëtar
11. Ukë Kryeziu, anëtar
12. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
13. Hajrije Salihu, anëtar
14. Blerim Gashi, anëtar
15. Adelina Krasniqi, anëtar
16. Florent Hoxha, anëtar
17. Petrit Kelmendi, anëtar
18. Lulzim Rustemi, anëtar
19. Nazmi Krasniqi, anëtar
20. Enver Kozhani, anëtar
21. Feriz Hasani, anëtar
22. Ali Stublla, anëtar
23. Valbona Shillova, anëtar
24. Burbuqe Ilazi, anëtar
25. Vlora Buja, anëtar
26. Arben Bahtiri, anëtar
27. Edita Gashi, anëtar
28. Ramiz Qeriqi, anëtar
29. Zoran Çirkovic, anëtar
30. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Sefer Tasholli, Nënkryetar i Komunës
3. Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBFsë

4. Fauz Xhemajli, Drejtor i Administratës
5. Rasim Hasani, Drejtor i arsimit
6. Basri Hashani, Drejtor i DRKS
7. Avdullah Fazliu, Drejtor i Shëndetësisë
8. Feti Krasniqi, Drejtor i BPZHR
9. Remzi Mehmeti, Drejtor i DSHM
10. Ilir Tasholli, Drejtor i DPU-së
11. Avni Olluri, Drejtor i DGJK
12. Heset Sahiti, Drejtor i DSHP
13. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
14. Imer Rrustemi, Drejtor i DI
15. Imer Kaçara, Komandant i Policisë
16. Vlora Krasniqi, shefe e zyres ligjore
17. Lumnije Ejupi, Shefe e sektorit pronoro juridik
18. Kimete Jashanica, përfaqësuese e OSBE-së
19. Qëndresa Jashanica, shefe e kabinetit
20. Bekim Krasniqi, "YAHR"
21. Përfaqësues të OJQ "POLIS" (1)
22. Përfaqësuesit e mediave
23. Numër i konsideruar i qytetarëve
24. Naser Bytyqi, perkthyes shqip-serbisht
25. Haki Avdiu , operator i zërimit

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Bajram Zaskoku**.

Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës e keni marr dhe të njejtin e lexoi në vazhdim e gjithashtu e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me të gjitha votat për të anëtarëve prezent për punën e kësaj mbledhje aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 24-të e KK-së
2. Njoftim me gjendjen e sigurisë në Komunën e Lipjanit për vitin 2015
3. Informatë për punën e KKS-së për vitin 2015.
4. Propozim Vendim për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2015
5. Propozim Vendim mbi dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2014 dhe 2015 në vitin 2016.
6. Propozim Rregullorja për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike
7. Propozim Rregullore për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit.
8. Propozim Vendim për miratimin e planit të veprimit për transparencë në Komunë
9. Propozim Vendim për miratimin e planit të veprimit kundër korrupsionit
10. Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës në ZK Babush i Muhaxherëve
11. Propozim Vendim për anulimin e pjesërishëm të vendimit 1nr.464-123 të dt.20.06.2006 dhe shkëputjen e kontratës 1-464-157 të dt.26.07.2006 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në ZK Konjuh (NTPSH. Sadovina).

12. Propozim Vendim për anulimin e pjesërishëm të vendimit 1nr.464-123 të dt.20.06.2006 dhe shkëputjen e kontratës 1-464-159 të dt.26.07.2006 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në ZK Konjuh (NTP Adriatik Commerc)

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 24-të e KK-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 24-të të Kuvendit?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë përkatësisht nuk pati vërejtje, Kryesuesja vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me të gjitha votat për të anëtarëve prezent

Aprovoi

Ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 24-të të Kuvendit pa vërejtje

Shtesë: Ekstrakti.

II

Njoftim me gjendjen e sigurisë në Komunën e Lipjanit për vitin 2015

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Imer Kaçarës, Komandant i stacionit të policisë në Lipjan, i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit duke shtuar se jam para jush me shumë kënaqësi për të paraqitur raportin mbi gjendjen e përgjithëshme të sigurisë në Komunën e Lipjanit. Në vazhdim tha se duke u bazuar në raportet e përgjithëshme të institucioneve relevante mund të konstatojmë se gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Lipjanit është stabile dhe e qetë, mirëpo kur merret qështja e sigurisë në nivel të vendit mund të themi se i kemi disa angazhime shtesë për shkak të problemeve në Kuvendin e Kosovës ku janë organizu protesta të ndryshme të opozitës.

Çështje tjetër është ngritja e nivelit organizativ për t'u ballafaquar në mundësinë e shfaqjes së ndonjë sulmi terrorist nga ana e ISIS-it. Në vazhdim paraqiti një prezantim tabelar të raportit përmes kinoprojektorit duke paraqitur të dhëna rreth organizimit operativ të stacionit policor në Lipjan si dhe të dhënat e krahasueshme me vitin paraprak nga puna e policisë siqë është asistime në raste të ndryshme, bastisje, rastet e aksidenteve në trafik, arrestime, zbatim i urdhëresave gjyqësore, patrullime në këmbë dhe me automjete. Pastaj foli lidhur me numrin e etiketave të shqiptuara në trafik ku në krahasim me vitet paraprake vërehet një rënje e dukshme. Në vazhdim foli për numrin e veprave penale për të cilat ofroi të dhëna të detajuara duke shtuar se edhe këto vepra në raport me vitin paraprak janë në numër më të vogël. Pastaj foli për rastet e abuzimit me substanca narkotike nga nxënësit nëpër disa shkolla të komunës tonë duke përmendur rastet veq e veq. Në vazhdim paraqiti të dhënat nga raporti lidhur me të gjithë nomenklaturën e nocioneve dhe termave të cilat e përbëjnë natyrën e punëve që lidhjen me punën e policisë në lidhjen me sigurinë e përgjithëshme me qytetarët. Në vazhdim përmendi vështirësitë me të cilat është ballafaquar policia e Kosovës në Lipjan gjatë kryerjes së aktiviteteve të tyre operative.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Linda Shahini, kisha kërkuar nga komandanti që të shtohet patrullimi i policisë nëpër fshatra.

Petrît Kelmendi, kam pyetje për komandantin lidhur me qështjen e aksidenteve se a është bërë ndonjë analizë e shkaqeve të atyre aksidenteve, periudha kur ka qenë më i madh numri i aksidenteve dhe masat që janë marrë?

Blerim Gashi, jemi deshmitarë të një gjendje jo stabile në Kosovë e posaqërisht lidhur me implikimin e Kosovarëve në ISIS. Në vazhdim pyeti se a ka grupe të organizuara dhe cilat janë masat për parandalimin e tyre?

Në vazhdim përmendi edhe disa ekcese siqë janë rrahja e nxënësve nëpër shkolla si dhe në qytet.

Hajrije Salihu, falenderoj komandantin për paraqitjen e raportit për punën e policisë por pyes për aksidentet që ndodhin dihet se policia e para duhet të shkoj në vend ngjarje mirëpo në rastin e fundit që ka ndodhur te Gllogovci policia nuk ka shkuar me kohë, pyes cili është mendimi i juaj për këtë?

Zoran Çirković, jemi të kënaqur për punën e policisë dhe po e potencoj se në krahësim në vitin paraprak vjedhjet në këtë vit kanë qenë minimale, gjithashtu kërkoj që në rast të ndonjë manifestimi të shkolla fillore serbe në Lipjan të dërgohet një patrullë e policisë.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, fillimisht përshëndeti të pranishmit e posaqërisht falenderoj komandantin e policisë për paraqitjen e raportit si dhe punën e policisë në përgjithësi duke shtuar se vitin që lam pas sipas raportit jep të kuptohet për një përmirësim të përhershëm të gjendjes së sigurisë. Për këtë u jam mirënjohës qytetarëve të cilët po tregojnë një qytetari të mirëfillt e pastaj angazhim i të gjithë institucioneve.

Çështja e ISIS-it në Lipjan është shumë e izoluar dhe nuk përbën problem meqë në Lipjan është numër minimal i njerëzve që përkrahin ISIS-in por falë edhe angazhimit të mirëfillt të Imamve nëpër Xhamitë e Lipjanit.

Vjedhjet e imta që u përmenden, rrahjet e nxënësve etj. ato kanë ndodhur e ndoshta do të ndodhin edhe në të ardhmen.

Imer Kaçara, lidhur me pyetjen e Lindës për angazhimet e patrullimeve shtesë në fshatra ju njoftoj se angazhimi i ynë është i përhershëm dhe ne po bëjmë më të mirën mbrenda mundësive tona por të kuptohemi se na kemi angazhime edhe jashtë Lipjanit dhe kjo ka bërë që ne të kemi ngecje dhe patrullime nëpër fshatra. Sa i përket pyetjes së Petritit se a është bërë ndonjë analizë për shkaqet e aksidenteve dihet se shkaktari i aksidenteve janë mospërshtatja kushteve të vozitjes, mos përshtatja e shenjeve të komunikacionit, cilësia e dobët e automjeteve etj. Sa i përket pyetjes së Blerimit ne në të gjitha rastet ku kemi pasur informime kemi bërë të gjitha angazhimet tona në lidhje me ISIS-in, mirëpo numri i anëtarëve të ISIS-it është shumë i vogël dhe kemi vetëm 1 të vrarë nga Lipjani dhe një familje e cila ka shkuar në ISIS. Raste tjera nuk kemi. Por ju ftoj edhe juve që në qdo rreth ku jetoni, punoni dhe veproni të jepni kontributin e juaj kundër ISIS-it. Lidhur me aksidentin të vendkalimi në Gllogovc ju them se unë jam në pushim dhe vonesa e policisë ka mundur të jetë për shkak të angazhimeve tjera në teren dhe kursesi nuk besoj se është bërë nga neglizhenca.

Lidhur me pyetjen e Zoranit rreth sigurisë në shkollën fillore serbe në Lipjan në rast të ndonjë manifestimi që të shtohen patrullat e policisë ju njoftoj se na në këso situatë qdo herë kemi dhënë kontributin tonë.

Lulzim Rrustemi, falenderoj komandantin për paraqitjen e raportit të detajuar duke shtuar se na nuk e kemi pasur këtë raport, andaj është mirë si asambleist të na dërgohet raporti në mënyrë që ta shqyrtojmë. Pastaj përmendi disa qështje si ajo e përdorimit të narkotikëve, vjedhjet në qytetin e Lipjanit duke pyetur se a janë grupe të organizuara dhe a është zënë ndonjë grup meqë vjedhje ka ende në qytetin e Lipjanit. Në fund pyeti se a kemi njohuri për veprimtari të pa ligjësvë të strukturave paralele serbe.

Imer Kaçara, rastet e përdorimit të narkotikëve i kemi gjithsej 4 raste ku dy prej tyre kanë qenë nga ana e nxënësve ndërsa 2 të tjera nga qytetarët. Ne jemi duke u marrë me këto raste por edhe me raste të reja të mundëshme por jemi edhe në bashkëpunim me

drejtorët e shkollave. Për vjedhjet kemi rënje të rasteve dhe janë identifikuar individ dhe grupe të hajnave të cilët disa janë arrestuar. Puna e jonë fokus e ka rritjen e qetësisë dhe sigurisë së qytetarëve, por me një numër kaq të vogël të policëve nuk mund të zbulojm gjithqka por duhet të na ndihmojnë qytetarët sepse qdo informatë do të na bëjë punë të madhe si shembull lëvizjet e dyshimta e veturave në kohë të ndieshme do duhej të paraqiten menjëherë në polici. Sa i përket veprimtarisë së strukturave paralele serbe ne nuk kemi asnjë informatë lidhur me këtë.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja falënderoj komandantin për paraqitjen e raportit për punën e policisë.

Pas përfundimit të kësaj pike Kryesuesja kërkoj nga anëtarët nëse ka dikush pyetje të parashtroj mund të parashtroj para se të kalojmë në pikën tjetër.

Florent Hoxha, shprehu shqetësimin lidhur me pastrimin e borës ku në disa rrugë pastrimi ka qenë në nivel por jo edhe në të gjitha zonat si psh. Në Kleçkë, Divjak pastaj edhe në fshatrat e larta mbi Gadime.

Në fshatin Shalë kompania që ka bërë pastrimin e borës e ka hedhur nëpër rrugët dytësore. Në vazhdim përmendi edhe dëmet që janë shkaktuar nga era e fundit dhe vërshimet.

Rizah Bajraktari, kërkoj nga Drejtorati i Shërbimeve Publike që të merr veprimet e nevojshme për vendosjen e një rampe te udhëkryqi i hekurudhës për Gllgovc sepse aty po kemi humbje jete.

Hajrije Salihu, shprehi shqetësimin lidhur me bibliotekën ku tha se dikur kishim një bibliotek me një fond të varfër të titujve kurse tani kemi një bibliotekë shumë të mirë por kemi një literaturë të mangët dhe klasifikimi jo adekuat i atyre librave posqërisht kur bëhet fjalë për letësinë. Aty duhet të bëhet një punë në sistemimin e atyre librave. Kisha kërkuar nga të gjithë ju që të bëni më shumë për informimin e nxënësve se ku gjendet biblioteka e qytetit duke vendosur një tabel me mbishkrimin për bibliotekën. Në fund kërkoj që në këtë bibliotek fondi i librave.

Merita Zeqiri, edhe unë pajtohem me profesoreshën Hajrije lidhur me bibliotekën. Qështje tjetër është heshtja e ardhjes së nxënësve nga fshatrat që me këtë rast po rritet numri i nxënësve nëpër klasë deri në 40 nxënës në klasë.

Enver Kozhani, pyetja lidhur me vërshimet e fundit na shtynë me kërku nga ekzekutivi që pakten në të ardhmen të bëhet pastrimi i shtretërve të lumenjëve në mënyrë që t'i iket vërshimeve dhe dëmtimit të sipërfaqeve të të mbjellave me kultura bujqësore. Pyetje tjetër kam lidhur me zhavorimin e rrugëve nëpër disa fshatra dhe mënyra e përzgjedhjes së operatorëve sepse po ka ngecje në realizimin e mirëfillt të projekteve.

Lulzim Rrustemi, pyeti Kryesuesen se a kanë marrë ndonjë peticion nga qytetarët. dhe pyetja e dytë ishte dalja e ujit nga kanalizimi dhe hyrja e këtij uji në puset që shërbejnë për ujësjellës në Lipjan. Mendoj se ky ujë përbën rrezik për ndonjë epidemi të mundëshme.

Feriz Hasani, foli lidhur me problemin e Lumit "Sitnica" dhe derdhjes së kanalizimeve në Lumin "Sitnica".

Heset Sahiti, sa i përket pastrimit të borës ne kemi përzgjedh kompanin Pastrimi për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve. Kjo kompani ka bërë një punë mjaft të mirë në pastrimin e borës në përjashtim që kemi pasur ngecje në fshatin Kleçkë, Teqe dhe Brus po në krahasim me praktikën e mëhershme gjendja ka qenë shumë më e mirë. Ne nuk jemi shumë të knaqr por ka mungesë edhe të kripes dhe ajo sasi që kemi jemi detyruar ta ruajmë për rrugët më të frekuentuara. Sa i përket zhavorimit të rrugëve kjo është bërë sipas paramasave si për nga gjatësia dhe gjërësia si dhe metra kub e rërës së planifikuar. Sa i përket kanalizimit në Lipjan ne do të kemi probleme me kanalizim deri sa të zgjerohet dhe thellohet shtrati i Lumit Sitnica sepse niveli i pikës shkarkuese të kolektorve nuk lejon derdhjen e mjaftueshme në Lumin "Sitnica". Sa i përket barrierave së propozuara ne i kemi 4

pika të kalimit të rrugës mbi hekurudhë dhe kjo duhet të rregullohet në bashkëpunim me hekurudhat e Kosovës.

Imri Ahmeti, në të mirë të sigurisë së të gjithëve lidhur me vendosjen e pengesës në mbikalimin tek hekurudha në fshatin Glllogovc, unë para 2-3 muajsh kam pasur një takim me Drejtorin e hekurudhave dhe prej tyre kam kërku që të eliminohen disa binar që po na paraqesin bukur problem posaqërisht në rrugën për në lagjen e Akllapit, pastaj ndërtimi i një nënkalimi etj. Qështja e pastrimit të borës ne nuk jemi edhe aq të knaqur, por mos të harrojmë se kemi pasur problem edhe gjatë viteve të kaluara dhe në vitin 2011 kemi pasur të angazhuar një operator privat "Prestigji" i cili edhe tash neve po na kushton me pagesë nga buxheti komunal . Qështja e zhavorimit të rrugëve që u shtru si pyetje po e lus Enverin dhe të gjithë të tjerët që edhe një metër nëse dikun mungon ta paraqesin me shkrim dhe unë do të përgjigjem sakt për secilin rast e jo të gjuhen saqme.

Qështja e bibliotekës ku pajtohem me të gjitha ato që u thanë, por ju sigurojë që po vijnë ditë të mira për këtë lëmi sepse ne i kemi nënshkru një marrëveshje bashkëpunimi me Minsitrinë e Kulturës e cila do të na mbështes.

Qështja e Lumit Sitnica dhe kanalizimeve ju them se ne jemi duke kërkuar mundësi për realizimin e projektit për rregullimin e shtratit të lumit "Sitnica" dhe zgjidhjen e problemeve me kanalizimet ku presim një kredi të butë pikërisht për qështjen e kanalizimeve.

Qështja e kompenzimeve të dëmeve nga era ne si komunë kemi bërë evidentimin e dëmeve dhe këtë e kemi proceduar në nivelin qendror.

Vlora Limani-Hajnuni, lidhur me rastin që e ngriti profesoresha Hajrije ju njoftoj se unë sa po mora një informatë nga stacioni i policisë ku thuhet se prej momentit kur është marr informata deri te arritja e policisë në vendin e ngjarjes është vetëm 6 minuta.

Feriz Hasani, tha se kemi shumë raste të ndërtimit të urave private dhe kërkoj që këto ura të ndërtohen sipas standardeve meqë gjatë kohës së vërshimeve po kemi probleme.

Meqë pyetje tjera nuk pati u kalua në punë sipas pikës së tretë.

III

Informatë për punën e KKS-së për vitin 2015.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Haqif Rustemit i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Informata mbi punën e KKS-së e cila sajton pjesën përbërëse të procesverbalit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Florent Hoxha, me gjithë informatën e zyrtarit të DMSH ne e dimë se kemi pasur edhe disa ngacje dhe besoj se në vitin 2016 do të ketë përmirësime. Në vazhdim pyeti se a janë identifikuar sfidat kryesore me të cilat do të ballfaqohet ky këshill si psh. qështja e trotuareve, trajtimi i qenëve endacak, vendosja e video kamerave etj.

Haqif Rustemi, këto që i ngriti Florenti siqë është trajtimi i qenëve endacak mund të them se kjo nuk është qështje vetëm e jona ndërsa sa i përket qështjes së zjarreve kjo do të trajtohet këtë vit me seriozitetin maksimal dhe se para jush do të sjellim një plan të detajuar për punën e KKS-së për vitin 2016.

Qështja e trotuareve neve na përket vetëm sa i përket identifikimit të shqetësimit të qytetarëve.

Në ora 12,⁴⁰ Kryesuesja dha pauzë deri në ora 13,⁴⁰.

Pas pauzës në ora 13,⁴⁰ Kuvendi vazhdoi punën sipas pikës së katërt

IV

Propozim Vendim për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2015

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF i cili njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit dhe arsyeshmërin e këtij Vendimi duke shtuar se rritja do të jetë 111,297,78€ dhe këto mjete do të destinohen për Drejtoratin e arsimit për realizimin e projektit për ndërtimin e shkollës fillore në fshatin Bujari.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, ky tejkalim po vije si rezultat i punës së mirë që po bënë ekzekutivi dhe e mira më e madhe është se ky tejkalim i mjeteve po destinohet për investime kapitale.

Petrit Kelmendi, përshëndes destinacionin e këtyre mjeteve dhe pyes se a mjaftojnë këto mjete për përfundimin e këtij projekti.

Adelina Krasniqi, edhe ne si grup parlamentar i AKR-se e përkrahim këtë propozim vendim.

Shkelzen Hajdini, dha sqarim shtesë në vlerën e tejkualuar duke ia shtuar edhe 18€ që janë realizuar nga MPJ, e po ashtu kemi një ndryshim edhe për 0.7cent dhe kërkoj nga ju që ta votoni këtë propozim Vendim me plotësimet që i ceka.

Pasi diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozim Vendimin me plotësimet e propozuara për ndryshim nga Drejtorit të konstatuara më lart dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me të gjitha votat unanime të anëtarëve aprovoi këtë:

VENDIM

PËR RITJEN E BUXHETIT TE KOMUNËS SË LIPJANIT NGA TEJKALIMI I TË HYRAVE VETANAKE PËR VITIN 2015

Neni 1.

Me këtë Propozim Vendim të bëhet rritja e planifikimit të buxhetit të të hyrave vetanake në shumë prej **111,315,71€**. Kështu që vlera e të hyrave vetanake të arkëtuara nga 1,342,336.07€ rritet në 1,453,651.78€.

Neni 2.

Mjetet nga Neni 1 i këtij Vendimi planifikohen të destinohen si vijon:

Investime Kapitale:

Arsim dhe Shkencë(920)Programi (93060):

“Ndertimi i Shkolles Fillore Bujari” (87259)..... 111,315,71€

Totali..... 111,315.71€

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 4.

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Neni 5.

Me këtë vendim të njoftohet Ministria e Financave, MAPL dhe Drejtorati për Buxhet dhe financa.

Shtesë: Vendimit.

V

Propozim Vendim mbi dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2014 dhe 2015 në vitin 2016.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF-së i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi duke shtuar se kjo bartje ka ndodh për arsye se viti fiskal për pagesat është mbyll më herët dhe inkasimi i të hyrave është bërë më vonë dhe këto mjete barten në vitin vijues buxhetore.

Vlera e propozuar për bartje nënkupton një vlerë prej 4% nga vlera totale e buxhetit të planifikuar për Komunën tonë.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, lidhur me propozimin për bartjen e mjeteve na i kemi analizu të gjitha tabelat e ofruara ku shihet se këtu gjithëshka është në përputhshmeri të plotë.

Ne jemi të kënaqur me këtë dhe e përkrahim këtë propozim Vendim.

Petrit Kelmendi, është mirë që mjetet vetanake edhe nëse nuk mund të realizohen për qfarë do arsye qoftë nuk humbin por këto mund të barten në vitin vijues.

Blerim Gashi, rritja e të hyrave vetanake tregon për një qeverisje të mirë edhe pse kjo vlerë duket e madhe krahasuar me buxhetin total kjo vlerë është e vogël.

Ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim vendim sepse ja vlen edhe destinimi i këtyre mjeteve.

Florent Hoxha, kur flasim për bartjen e mjeteve kjo është gjë e mirë. Te tabela 5.2 kur flitet për bartjen e mjeteve për shkollën e Bujarisë na del vlera 139.000,00€ qka do të thot se është një ndryshim prej afër 23.000,00€. Te programet dhe kategoritë kemi disa mangësi të informatave për burimin e mjeteve si dhe mbetjet dhe është mirë që të na ofroni sqarime shtesë.

Shkelzen Hajdini, falenderoj për pyetjet dhe vërejtjet e juaja. Këto mjete nuk mjaftojnë për projektin e Bujarisë dhe e dijmë atë qështje por me këto mjete që i kemi do të vazhdojmë kryerjen e atij projekti. Pyetja tjetër ishte bartja e mjeteve nga kategoria e 22-të dhe arsyeja se pse nuk janë hargjuar ato mjete me kohë është se këto mjete janë nga mbetjet nga projektet që edhe pse janë me vlera minore kur të grumbullohen nga të gjitha kodet ekonomike del një vlerë e konsideruar e madhe.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuhi vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi këtë:

VENDIM

MBI DHËNJEN E PELQIMIT PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE TË KOMUNËS SË LIPJANIT TË VITIT 2014 DHE 2015 NË VITIN 2016

Neni 1.

Me këtë Vendim barten të hyrat vetanake në shumë prej 540,217,.61€ që i përkasin viteve:

-Viti 2015..... 509,985.49€

-Viti 2014.....30,232.12€

Neni 2.

Mjetet nga Neni 1 i këtij Vendimi barten:

Tabela 1 Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2015 (21) në Mallra dhe Sherbime prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma
-Administrata (163)Programi -16303 shuma prej	23,793.44
-Infrastruktura Publike (180) Programi -18163 shuma prej	1,923.34
-Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale(730)Programi -73200 shuma prej	9,953.69
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-92250 shuma prej	23,822.48
-Arsim dhe shkencë (920) Programi-93060 shuma prej	43,462.45
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-94260 shuma prej	21,155.79
Totali për Bartje	124,111.19

Tabela1.1 Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2014 (22)në Mallra dhe Shërbime prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma
-Zyra e kryetarit(160)Programi-16003 shuma prej	34.26
-Administrata (163)Programi -16303 shuma prej	9,755.37
-Buxhet dhe Financa(175) Programi 17503 shuma prej	6,852.14
-Infrastruktura Publike (180) Programi -18163 shuma prej	3,792.62
-Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale(730)Programi -73200 shuma prej	28.98
-Sherbimet Kulturë, Rini dhe Sport(850) Programi-85003 shuma prej	50.92
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-92015 shuma prej	13.90
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-92250 shuma prej	375.47
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-93060 shuma prej	496.75
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-94260 shuma prej	363.92
Totali për Bartje	21,764.33

Mjetet nga tabela 1(të hyrat e vitit 2015) dhe mjetet nga tabla 1.1 (të hyrat e vitit 2014) barten në tabelën

1.2. Mallra dhe Sherbime:

Tabela nr.1.2.

PROGRAMI	Shuma
-Zyra e kryetarit(160)Programi-16003 shuma prej	3,000.00
-Administrata (163)Programi -16303 shuma prej	33,583.07
-Infrastruktura Publike (180) Programi -18163 shuma prej	7,715.96
-Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale(730)Programi -73200 shuma prej	9,982.67
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-92250 shuma prej	24,197.95
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-93060 shuma prej	40,510.65
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-94260 shuma prej	16,519.71
-Buxhet dhe Financa(175) Programi 17503 shuma prej	10,365.51
Totali për Bartje	145,875.52

Tabela 2. Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2015 (21) në Komunali prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma
-Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale(730)Programi -73200 shuma prej	227.10
Totali për Bartje	227.10

Tabela2.1. Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake te vitit 2014 (22)në Komunali prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma
-Zyra e kryetarit(160)Programi-16003 shuma prej	3,100.00
Totali për Bartje	3,100.00

Mjetet nga tabela 2 dhe 2.1 barten në tabelen 2.2. në Komunali

Tabela nr. 2.2

PROGRAMI	Shuma
-Administrata (163)Programi -16303 shuma prej	3,100.00
-Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale(730)Programi -73200 shuma prej	227.10
Totali për Bartje	3,327.10

Tabela 3. Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2015 (21) në Subvencione dhe Transfere prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma
-Zyra e kryetarit(160)Programi-16003 shuma prej	203.00
-Bujqësia (470) Programi -47003 shuma prej	3,000.00
-Shërbimet sociale (755) Programi -75511 shuma prej	100.00
Totali për Bartje	3,303.00

Tabela 3.1. Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2014 (22) në Subvencione dhe Transfere prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma
-Zyra e kryetarit(160)Programi-16003 shuma prej	455.00
-Bujqësia (470) Programi -47003 shuma prej	0.52
-Administrata e Shendetësisë (730)Programi 73012	0.50
Totali për Bartje	456.02

Mjetet nga tabela 3 dhe 3.1 barten në tabelën 3.2. në Subvencione dhe Transfere në këto programeve:

Tabela 3.2

PROGRAMI	Shuma
-Zyra e kryetarit(160)Programi-16003 shuma prej	658.00
-Bujqësia (470) Programi -47003 shuma prej	3,000.52
-Shërbimet sociale (755) Programi -75511 shuma prej	100.50
Totali për Bartje	3,759.02

Tabela.4. Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2015 (21) në Paga dhe Meditje prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma
-Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale(730)Programi -73200 shuma prej	10,866.74
Totali për Bartje	10,866.74

Mjetet nga tabela 4 barten ne tabelen 4.1 në Paga dhe Meditje prej këtyre Programeve:

Tabela 4.1

PROGRAMI	Shuma
-Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale(730)Programi -73200 shuma prej	10,866.74
Totali për Bartje	10,866.74

Tabela 5. Mjetet e Mbetura nga të hyrat vetanake(21) në Investime Kapitale prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),,Asfaltimi i rrugës fshati Dobaraje e Madhe (40149)	0.04
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),,Asfaltimi i rruges fshati Rufc (40153)	26,341.40
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),,Mirembajtja e rrjeteve te kanalizimeve (40155)	22.08
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),,Rehabilitimi i rrjetit te kanalizimit ne fshatin Kraishtë”(40157)	2,612.64
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),,Bashkëfinancim me donatore”(40163)	94,000.00
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),,Pastrimi dhe hapja e lumenjeve (40164)	0.97
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),,Asfaltimi i rruges fshati Sllovi (40194)	1,957.15
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),,Ujesjellesi Shalë (40197)	0.21
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),,Zgjerimi i rrjetit te kanalizimit ne fshatin Poturovc”(41802)	5.00
-Planifikimi Urban dhe Mjedis- Programi (66320)”Hartimi i Projekteve Detale”(40200)	45,308.65
-Sherbimet e Kujdesit Primar Shendetesor-Programi (73200)”Renovimi i Aneksit te laboratorit ne QKMF (84610)	56.06
- Sherbimet Kulturë, Rini dhe Sport(850) Programi(85003)”Ndertimi i salles se sporteve SHF.Dobaraje e Madhe (40204)	48,577.00
- Sherbimet Kulturë, Rini dhe Sport(850) Programi(85003)”Ndertimi i salles se sporteve Shalë (40208)	17,254.05
- Sherbimet Kulturë, Rini dhe Sport(850) Programi(85003)”Blerja e inv.per biblioteken e qytetit”(84611)	180.00
-Arsim dhe Shkencë(920)Programi (92015)” Blerja e paisjeve elektrike per kyqje te shkollave”(84612)	15,000.00
-Arsim dhe Shkencë(920)Programi (93060)”Rregullimi i infr.SHF.Medvec”(40225)	18.00
-Arsim dhe Shkencë(920)Programi (93060)”Ndertimi i rrethojave SHF.Krishte dhe I.Luma –Lipjan (41803)	3,500.00
-Arsim dhe Shkencë(920)Programi (93060)”Ndertimi i shkolles fillore fsh.Bujan”(80120)	2,487.00
-Arsim dhe Shkencë(920)Programi (93060)”Ndertimi i trotuareve ne SHF 7 Marsi Poturovc”(84613)	8.00
-Arsim dhe Shkencë(920)Programi (93060)”Ndertimi i kulmit në SHF Risinove”(84614)	2,831.00
-Arsim dhe Shkencë(920)Programi (93060)”Rregullimi i infr. Dhe rrenimi i shkolles se vjeter Kraishte (84616)	2.50
-Arsim dhe Shkencë(920)Programi (93060)-“Ndertimi i Shkolles Fillore Bujari”(87259)	111,315.71
Totali për Bartje	371,477.46

Tabela 5.1. Mjetet e Mbetura nga të hyrat vetanake(22) në Investime Kapitale prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),, Rehabilitimi i kanaliz.fsh.Bujari” F.I (84573)	3,154.22
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),,Asfaltimi i rrugës Shqipëria-Hajredin Bajrami”(89225)	0.96
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),,Asfaltimi i rrugeve brenda në qytetin e Lipjanit”(89228)	4.15
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),,Rregullimi i trotuareve në qytetin e Lipjnit”(89232)	0.70
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),, Rregullimi i kanalizimit në fsh.Kojškë”(89233)	0.90
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),,Bashkëfinancim me donatorë”(89240)	1,750.84
Totali për Bartje	4,911.77

Mjetet nga tabela 5 dhe 5.1. barten në tabelen 5.2 barten në këto projekte:

Tabela 5.2

PROGRAMI	Shuma
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),,,Asfaltimi i rruges fshati Rufc (40153)	26,341.40
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),,,Rehabilitimi i rrjetit te kanalizimit ne fshatin Kraishtë”(40157	2,612.64
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),,,Bashkëfinancim me donatore”(40163)	94,000.00
-Planifikimi Urban dhe Mjedis- Programi (66320)”Hartimi i Projekteve Detale”(40200)	45,308.65
- Sherbimet Kulturë, Rini dhe Sport(850) Programi(85003)”Ndertimi i salles se sporteve SHF.Dobraje e Madhe (40204)	48,577.00
- Sherbimet Kulturë, Rini dhe Sport(850) Programi(85003)”Ndertimi i salles se sporteve Shalë (40208)	17,254.05
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),,, Rehabilitimi i kanaliz.fsh.Bujari” F.I (84573)	3,154.22
-Arsim dhe Shkencë(920)Programi (93060)-“Ndertimi i Shkolles Fillore Bujari”(87259)	139,141.27
Totali për Bartje	376,389.23

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Neni 4.

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Neni 5.

Me këtë vendim të njoftohet Ministria e Financave, MAPL dhe Drejtorati për Buxhet dhe financa.

Shtesë:Vendimi.

VI

Propozim Rregullorja për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Ilir Tasholli, Drejtor i DPU, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Petrit Kelmendi, falenderoj Drejtorin dhe dashta të pyes se qka do të ndodhë me ato objekte që janë në kundërshtim me këtë Rregullore, e gjithashtu qka do të ndodhë edhe me objektet që kanë leje të përkohshme.

Nehat Terpeza, na grupi parlamentar i LDK-se e kemi analizuar këtë Rregullore dhe e vlerësojmë shumë sepse përmes kësaj do të rregullohet shumëqka në këtë lëmi, gjithashtu kjo Rregullore do reflektoj pozitivisht në planin urban të qytetit të Lipjanit.

Xhevat Olluri, në emër të asambleistëve të AAK-se e përkrahim këtë Rregullore me vërejtjen që aty ku bëhet fjalë për antenat transmetuese dhe satelitore të thuhet që për këto të nxirret një Rregullore e veçantë duke ditur se këto objekte mund të ndikojnë negativisht në ambientin jetësor sepse rrezatojnë energji jonizuese të cilat janë të dëmshme për shëndetin tonë.

Blerim Gashi, kjo është një lëmi që rregullon një qështje të gjërë të organizimit të jetës publike të qytetarëve. Unë në KPF kam dhënë vërejtje lidhur me përmendoret dhe pllakat

përkujtimore që mos të trajtohen si objekte të përkohshme, ndërsa sa i përket vendosjes së antenave ekziston protokoll strik për vendosjen e antenave.

Lulzim Rrustemi, kjo Rregullore ka një spektër të gjërë të mbuluar mirë por unë kam një vërejtje te neni 2 kur bëhet fjalë për vendosjen e objekteve të përkohshme kërkoj që vendosja e tyre të bëhet në harmonizim me planin zhvillimor urban të Lipjanit dhe planin zhvillimor komunal. Plotësim tjetër kam te neni 10 është mirë me u hjekë fjala huaj city light dhe kjo fjalë të shkruhet shqip se unë nuk pe di edhe qka do të thot kjo fjalë. Gjithashtu fjala hulaja apo luhaja të shiqohet cila është shprehje e drejtë.

Ilir Tasholli, Drejtori u përgjegj në pyetjet e delegatëve.

Florent Hoxha, Drejtori tha se përmendoret dhe pllakat përkujtimore dhe lapidarët nuk janë të evidentuara por unë e di se një komision i veçant është marrur me evidentimin e këtyre kategorive. Në vazhdim tha se sa janë duke u mirëmbajtur ato nga institucionet është diqka tjetër përveq që mbahen nga familjarët e tyre.

Xhevat Olluri, në përgjigjen e drejtorit u tha se antenat trajtohen në mënyrë të veçant nga Ministria e pikërisht për ato edhe unë po kërkoj trajtim të veçant edhe nga ne sepse ato vërtetë ndikojnë negativisht në shëndetin tonë.

Hajrije Salihu, të gjitha materialet duhet të lektorohen dhe të na vijnë komplet psh. te fjala hulaj unë e di fjalën kolovajzë, pastaj teras – verand etj. e deri sa kemi gjuhën standarde do të ishte mirë t'i përmahemi sa më shumë.

Blerim Gashi, unë vazhdoj të insistoj se kategorizimi i përmendoreve dhe pllakave përkujtimore në objektet e përkohshme është gabim dhe ndoshta do të ishte më mirë që këto të trajtohen me Rregullore të veçant.

Ilir Tasholli, normal unë e di që ekziston regjistrimi i përmendoreve dhe lapidarëve por jo edhe mirëmbajtja e tyre, pastaj përmendi disa objekte të trashëgimisë kulturore të mbrojtura me Ligj por jo edhe për mirëmbajtjen e tyre nga institucionet lokale.

Në planifikimin urban komunal nuk specifikohen vendet se ku do të vendosen përmendoret, andaj mbetet të përcaktohen me Rregullore apo Vendime nga Kuvendi. Shumë antena në komunën tonë nuk kanë leje nga Ministria e ambientit për vendosjen e tyre.

Vlora Limani-Hajnuni, vuri në votim propozimin e Rregullores dhe para se të votohet ndërhyri Lulzim Rrustemi i cili kërkoi nga Kryesuesja që propozimet që u dhan gjatë diskutimeve të përfshihen në Rregullore.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese, tha se po më vjen keq që çdo herë po duhet me përsëritë Rregulloren e Kuvendit dhe konkretisht nenin 17-të për propozimin e amandamenteve duke shtuar se në nenin 17.1 thuhet se Kryetarët e grupeve parlamentare dhe anëtarët e Kuvendit pas marrjes së ftesës dhe materialeve për mbledhjen e Kuvendit, kanë të drejtë të parashetrojnë amandamente duke dhënë arsyetimin me shkrim përkitazi me projektet e akteve të cilat do të shqyrtohen në Kuvend dhe këto amandamente e dërgohen Kryesueses së Kuvendit më së vonit 3 ditë para datës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes.

Pastaj vuri në votim propozimin e Rregullores dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 vota për, asnjë kundër, dhe 10 apstenime aprovoi,

Rregulloren

Për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike

Shtesë: Rregullorja.

VII

Propozim Rregullore për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Heset Sahiti, Drejtor i DSHP, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja duke shtuar se të gjitha vërejtjet nga seanca e kaluar janë inkorporuar në këtë Rregullore.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Labinot Shahini, në seancën e kaluar ne i kemi dhënë vërejtjet tona dhe dje në KPF kemi pa se ato vërejtje janë përfshi në Rregullore, andaj ne e përkrahim këtë Rregullore.

Enver Kozhani, në mbledhjen e kaluar ne i kemi dhënë vërejtjet tona të cilat janë përfshi në këtë Rregullore dhe si të tillë ne e përkrahim.

Blerim Gashi, edhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë Rregullore meqë janë përvshi vërejtjet nga mbledhja e kaluar.

Xhevat Olluri, fillimisht po them se na e përkrahim këtë propozim Rregullore dhe para kësaj unë kam përgatitur disa propozime me shkrim të cilat ndoshta edhe të merreshin parasysh. Në vazhdim tha se derisa KEDS-i ka mundësi me e matë hargjimin e energjisë, ndërsa për mbeturina nuk ekziston një kriter matës. Unë propozoj që ky obligim të ngarkohet bashk me tatimin në pronë.

Petrit Kelmendi, unë e përkrahi këtë propozim Rregullore por edhe në KPF kam bërë vërejtjet e mija lidhur me tarifat për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave si dhe të krijohet një bazë ligjore e cila e ngarkon ose e lejon nga obligimi i pagesës ekonomitë familjare.

Heset Sahiti, qështja e operatorëve nuk është e kufizuar vetëm në një operator dhe mund të fusim edhe më shumë operatorë por kjo dihet se duhet të kaloj përmes procedurave të prokurimit ku edhe parashtrohen sanksione për mos përmbushjen e obligimeve për bartjen e mbeturinave. Rreth Ligjit për inkasimin meteve financiare nga konsumatorët unë mendoj se kompanit janë ato që duhet ta bëjnë at inkasim.

Në vazhdim tha pamvarsisht nga numri i anëtarëve të familjes tash për tash ngarkesa bëhet për ekonomi familjare dhe nuk mirret për kriter numri i anëtarëve për ekonomit familjare.

Pasi që diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Rregullores pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, asnjë kundër aprovoi

Rregulloren

Për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit.

Shetsë: Rregullorja

VIII

Propozim Vendim për miratimin e planit të veprimit për transparencë në Komunë

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Fauz Xhemaji, Drejtor i DA, i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi për miratimin e planit si dhe me të dhënat nga plani i transparencës.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Linda Shahini, ne si grup parlamentar i LDK-se e përkrahim këtë propozim Vendim.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për aprovoi këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË
NË KOMUNË

Neni 1

MIRATOHET , Plani i Veprimit për transparencë për transparencë në Komunë .

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i Veprimit për transparencë në Komunë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Administratë.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës .

Shtesë: Vendimi.

IX

Propozim Vendim për miratimin e planit të veprimit kundër korrupsionit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Fauz Xhemajli, Drejtor i DA i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit si dhe me planin e veprimit kundër korrupsionit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Blerim Gashi, këto plane siqë është plani për transparencë dhe kundër korrupsion e plotësojnë njëra tjetrën dhe unë u jap mbështetje të fuqishme këtyre polaneve. Na para 2-3 ditëve e pamë një raport ku vërehej se Kosova është e zhytur thell në korrupsion dhe ne nuk mund të presim integritet me këtë nivel të korrupsionit.

Hajrije Salihu, unë propozoj që të zëvendësohet termi korrupsion me termin hajni ose vjedhje.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për aprovoi këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT KUNDËR KORRUPSIONIT

Neni 1

MIRATOHET , Plani i Veprimit kundër korrupsionit .

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i Veprimit kundër korrupsionit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen të gjitha organet e administratës komunale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës .

Shtesë:Vendimi.

X

Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës në ZK Babush i Muhaxherëve

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Ilir Tashollit Drejtor i DPU-së i cili në vazhdim i njoftoi të pranishme me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Xhevat Olluri, unë kam disa vërejtje lidhur me përpilimin e vendimeve që na vijnë nga ekzekutivi konkretisht kam vërejtje te neni 6 dhe 7 e poashtu kam vërejtje te përpilimi i titullit të vendimit e gjithashtu edhe te koha e hyrjes në fuqi të vendimeve meqë me Statut të Komunës afati i hyrjes në fuqi të vendimit është 8 ditë a në vendim është thënë 15 ditë nga data e rexhistrimit në protokolin e MAPL-së dhe shpalljes në Web faqen e komunës.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese, ne përpilimin e vendimeve e harmonizojmë me legjislacionin në fuqi dhe jemi të obliguar që t'u përmbahemi ligjeve të cilat i rregullojmë fushat e caktuara lidhur me vendimet tona.

Florent Hoxha, vërejtjet që i dha Xhevati po i përkrahi sepse për ate jemi ne këshillëtarët komunal, ndërsa lidhur me pikën në fjalë edhe unë i kam po ato vërejtje dhe do të duhet që ato vërejtje të merren parasysh. Ne ju kemi dhënë vërejtje lidhur me këtë pikë por jemi mbi votuar dhe tash ka dal se ky vendim ishte jo ligjor dhe tani Ministria e ka kthyer këtë vendim me të cilin duhet të meremi prap ne. Lidhur me këtë vendim ne po bëjmë shkelje të procedurave sepse ai operator e ka shkelur procedurë e aplikimit sepse i ka kaluar afati që një vit e gjysëm.

Labinot Shahini, këtë vendim e kemi marrë me një mbledhje më herët dhe nga Ministria kemi marrë sygjerrime për disa plotësime dhe ne po e shohim se ato vërejtje janë plotësuar tani dhe jemi që ky propozim vendim të aprovohet.

Lulzim Rrustemi, po më vjen mirë që institucionet qëndrore po e zbatojnë ligjin dhe parregullsitë tona dhe po na i kthejnë në rishqyrtim dhe besoj se edhe vendimet tjera do të kthehen.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 vota për, 10 kundër, 1 abstenim aprovoi këtë:

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK BABUSH I MUHAXHERËVE

Neni 1

Me këtë Vendim ipet në shfrytëzim afatgjatë prej 20 vitesh personave fizik dhe juridik paluajtshmëria që gjendet në zonën kadastrale në Babush i Muhaxherëve me sipërfaqe prej 0.50,00 ha pjesë e ngastrës kadastrale P-71409059-00562-1 në vendin e quajtur "Balkan" me kulturë kullosë e kl.V-të me sipërfaqe të përgjithshme prej 21.16,66 ha e evidentuar në Certifikatën nr.1488/2015 ZK Babush i Muhaxherëve, Kuvendi Komunal Lipjan.

Neni 2

Anulohet Vendimi i Kuvendit Komunal Lipjan 15Nr.464-57885/2015 dt.25.11.2015 për vazhdimin e vendimit të KK Lipjan 1nr.465-168 të dt.13.04.2004 për shfrytëzim të sipërfaqes së paluajtshmërisë.

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së komunës është ndërtimi i ndonjë fabrike prodhuese-përpunuese, objekte tregtare apo të ngajshme, sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

Neni 4

Sipas nenit 1 të këtij vendimi prona ipet në shfrytëzim në afat prej 20 vitesh nëpërmjet konkursit publik të përcaktuar sipas Rregullores QRK nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Procedurën e konkursit publik e zbaton Komisioni Vlerësues në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal 15 Nr.404-13205 të dt.31.03.2014, dhe Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso- juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati i Prokurimit dhe Drejtorati për Inspektion.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

XI

Propozim Vendim për anulimin e pjesërishëm të vendimit 1nr.464-123 të dt.20.06.2006 dhe shkëputjen e kontratës 1-464-157 të dt.26.07.2006 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në ZK Konjuh (NTPSH. Sadovina).

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Avni Olluri, Drejtor i DGJK, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 16 vota për, 1 kundër, 10 abstenim aprovoi këtë:

VENDIM

PËR ANULIMIN E PJESËRISHËM TË VENDIMIT 1NR.464-123 TË DT.20.06.2006 DHE SHKËPUTJEN E KONTRATËS 1-464-157 TË DT.26.07.2006 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK KONJUH

Neni 1

ANULOHEM pjesërisht Vendimi 1Nr.464-123 të dt.20.06.2006 i Kuvendit Komunal Lipjan për aprovimin e raportit të punës së komisionit për vlerësimin e konkursit publik për dhënien e tokës komunale në shfrytëzim afatgjatë në komunën e Lipjanit dhe SHKËPUTET Kontrata 1-464-157 dt.26.07.2006 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh të pronës së paluajtshme P-71409036-00164-15 në vendin e quajtur “Branjesh” me sipërfaqe prej 13000m², (një hektar e tridhjetë ari) ZK Konjuh në pronësi të komunës, e lidhur në bazë të Vendimit 1Nr.464-123 të dt.20.06.2006 ndërmjet komunës së Lipjanit e përfaqësuar nga ish Kryetari i Komunës Xhevat Olluri dhe ish menaxheri i prokurimit Shemsi Azemi (në tekstin e mëtejshëm-Komuna) si dhënësi i tokës ndërtimore në shfrytëzim afatgjatë dhe shfrytëzuesit të

tokës ndërtimore NTPSH "SADOVINA" me seli në Viti përfaqësuar nga Nexhat Fetahu (në tekstin e mëtejshme-investitori).

Neni 2

Anulimi i pjesërishëm i Vendimit 1Nr.464-123 të dt.20.06.2006 dhe shkëputja e Kontratës 1-464-157 dt.26.07.2006 bëhet për arsye se shfrytëzuesi i tokës ndërtimore NTPSH "Sadovina" nuk e ka përmbushur detyrimin kryesor-funksionalizimin e objektit "Fabrikë për prodhimin e profileve të çelikut, karrocave të dorës, gypave, valorizimin e llamarinës së zingtuar dhe kuposjes së llamarinave" që rrjedhë nga neni 5 par.5.2 i kontratës, ndërsa në par.5.2.1 përcaktohet se afati 3 vjeçar fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së lejes ndërtimore, ky afat 3 vjeçar sipas par.5.3 nënkupton edhe periudhën kur objekti duhet të lëshohet në përdorim dhe të filloj veprimtaria afariste" ashtu siq ka qenë i obliguar me kontratë.

Neni 3

Obligohet shfrytëzuesi i tokës ndërtimore NTPSH "Sadovina" që në bazë të detyrimeve kontraktore të cekura në par.11.3 të nenit 11 të kontratës 1-464-157 dt.26.07.2006 në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi ta kthen ngastrën kadastrale nr 00164-15 në gjendjen e mëparshme me shpenzimet e tij.

Neni 4

Obligohet DGJK-Sektori për gjeodezi dhe kadastër, që të ndërmerr të gjitha veprimet procedurale për ndryshimin-heqjen e të drejtës së shfrytëzimit nga NTPSH "Sadovina" të ngastrës kadastrale 00164-15 në vendin e quajtur "Branjesh" me sipërfaqe prej 13000m², të evidentuar në Certifikatën nr.05/2016 ZK Konjuh, P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan shfrytëzim 99 vite NTPSH "Sadovina" dhe kthimin e saj në librat publike P.SH KUVENDI KOMUNAL LIPJAN (siq ka qenë para dhënies së tokës në shfrytëzim).

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso- juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati i Prokurimit dhe Drejtorati për Inspektion.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

XII

Propozim Vendim për anulimin e pjesërishëm të vendimit 1nr.464-123 të dt.20.06.2006 dhe shkëputjen e kontratës 1-464-159 të dt.26.07.2006 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në ZK Konjuh(NTP Adriatik Commerc)

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Avni Olluri, Drejtor i DGJK, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit, duke shtuar me ndryshimin e nenit 2 të këtij propozim Vendimi në raport me materialin të cilin e keni marr më herët.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Ali Stublla, unë edhe në mbledhjen e kaluar kam kërkuar një regjistër të operatorëve të cilët nuk ju kanë përmbartur kushteve të kontratës e jo vetëm për këta dy emra të cilët na i keni sjellë sot.

Xhevat Olluri, pyeti se a do t`u mirret ajo sipërfaqe atyre operatorëve?

Avni Olluri, lidhur me pyetjen e Aliut ne i kemi dhënë premtim se do t'i bëjmë transparente të gjitha kontratat dhe para jush do t'i sjellim në qdo seancë dhe kur do të përfundojmë do tu themi se mbaroi qështja e mandej ju munt t'i ngritni qështje.

Sa i përket pyetjes së profesorit Xhevat lidhur me ato dy nga 25 ari ne do të marrim vetëm atë 1ha, ndërsa nga 25 mbeten në shfrytëzim.

Lulzim Rrustemi, këto propozim Vendime janë të mangëta dhe pa analizë të kostos financiare që ju ka kushtuar atyre operatorve ekonomik dhe na si grup parlamentar nuk do t'i i përkrahim këto propozim Vendime.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 16 vota për, kundër nuk pati 10 apstenime aprovoi këtë:

Pasi qështje tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 16,³⁰

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni